

VENDIM
Nr. 657, datë 31.10.2018

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT LICENCUES HEKURUDHOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 142/2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Funkcionet e Autoritetit Licencues Hekurudhor do të kryhen nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama